

AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“THABET CONSTRUCTION” SH.P.K.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“THABET CONSTRUCTION” Sh.p.k.**

- 1- **HISHAM THABET HUSSEIN AL-HOOT** atesia **THABET** , shtetas **YEMEN** , lindur me 23.07.1983 ne **TAIZ-YEM**, identifikohet nepermjet pasaportes 08110348.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“THABET CONSTRUCTION” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

NENI 1
FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale **SH.P.K.**, dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **“THABET CONSTRUCTION” Sh.p.k.**,

NENI 2
BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3
SELIA

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga **“DESHMORET”** Lagja nr. 4, Godina me xhama ,afër karburant **ALPET** ,kati i 3 ,Zyra 66 ,Nr. Pronesie 6/62,zona kadestrale 8514, Durrës, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

[Signature]

[Signature]

[Signature]

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "THABET CONSTRUCTION" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie e cila ka si objektiv punime në fushën e ndërtimit.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndarë në 1 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1. HISHAM THABET HUSSEIN AL-HOOT	100,00%	100.000,00 LEKE
----------------------------------	---------	-----------------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqëria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

AKT THEMELIMI "THABET CONSTRUCTION"

Jona Lupa

2

[Signature]

[Signature]

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "THABET CONSTRUCTION" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezigjatja dhe kompetencat e tyre. Administratorët e shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emeruar:

1. HISHAM THABET HUSSEIN AL-HOOT

2. JONA LUGA

Te cilet mund te ushtrojne kompetencat e tyre se bashku ,ose edhe vec e vec .

NENI 9

DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane 04/12/2020

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "THABET CONSTRUCTION" SH.P.K.

HISHAM THABET HUSSEIN AL-HOOT

هشام الحوت

Jona Luga

